

**V E N D I M**  
**I A S A M B L E S E S E O R T A K E V E**

Sot me daten 20.6.1998 ne seline e shoqerise "BIRRA KORÇA" ShPK Korce, u thirr mbledhja e asamblese se ortakeve, ne te cilen morren pjese ortaket:

- |                       |            |      |                               |
|-----------------------|------------|------|-------------------------------|
| 1- Minella Cami       | qe zoteron | 2/21 | pjese te kapitalit themeltar; |
| 2- Gaqo Menkshi       | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 3- Mina Kote          | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 4- Franko Saro        | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 5- Romeo Veriga       | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 6- Vasil Pashko       | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 7- Gjergji Asllani    | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 8- Thoma Boshka       | " "        | 2/21 | " " "                         |
| 9- Kajmak Bardhollari | " "        | 1/21 | " " "                         |

te cilet perfaqesojne mbi 3/4 pjese te kapitalit themeltar dhe per kete arsye mbledhja eshte e vlefshme. Nuk marrin pjese ne mbledhje ortaket Thanas Qeleshi, i cili ka vdekur dhe Gjergji Pojani, i cili eshte perjashtuar.

U propozuan dhe u zgjodhen unanimisht per drejtimin e mbledhjes kryetar Minella Cami dhe sekretar Mina Kote.

Mbledhja, nder te tjera, mori ne shqyrtim edhe kete pike te rendit te dites:

1- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kontributit ne para dhe kontributeve ne natyre, te vleresuar nga nje ekspert per kontributet, te caktuar prej gjykates, raporti i te cilit do te depozitohet ne regjistrin tregetar, duke u ruajtur raporti i pjesmarrjes se cdo ortaku te shoqerise ne kapitalin themeltar.

Ne perfundim ajo miratoi kete rend dite.

Persa me siper:

Ne baze te nenit 14 te statutit dhe neneve 60 dhe 63 te ligjit 7638 date 19.11.1992

**V E N D O S I**

1- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet kontributit ne para dhe kontributit ne natyre te vleresuar nga eksperti per kontributet i caktuar prej gjykates, raporti i te cilit te regjistrohet ne regjistrin tregetar.

SEKRETARI

Mina Kote



KRYETARI

Minella Cami

